



Ekskursioni i shkollës

nga Paul Mar

übersetzt von Gladiola Sadiku



Tina dhe Timi janë shokë.

Dhe që nga ky vit shkollor ata janë madje në të njëjtën klasë.

Mësuesja e tyre quhet zonja Bode.

Zonja Bode është shumë e sjellshme. Ajo ka ide të mira.

Ajo planifikon një ekskursion me klasën. Disa duan të ecin në natyrë, të tjerët duan të udhëtojnë më mirë me autobus.

- Është më mirë ti bëjmë të dyja - thotë zonja Bode.
- Udhëtojmë me autobus deri në Staigerwald. Pastaj e lëmë autobuzin në skaj të pyllit dhe ecim deri te një rrënojë.
- Për te cila rrëcoke do të ecim? – pyet Jörn.
- Te një rrënojë, - e korrigjon Tina.

Ajo është një shtëpi e prishur.

Zonja Bode tund kokën.

- Po, janë mbetjet e një kalaje të vjetër kalorësish. Me mure shumë të trasha dhe një kullë të lartë.



Të mërkurën herët në mëngjes takohen të gjithë në sheshin Shiller.

Atje po priste autobuzi. Nisja u bë në orar.

Autobuzi ndaloi pas tri orësh në fund të pyllit. Shoferi thotë:

- Unë po pres këtu ndërkohë.



Disa nga klasa duan të largohen menjëherë me vrap.

Zonja Bode thërret:

- Jo kaq shpejt. Kur të ecim në pyll, vlejné këto rregulla:
- Do të qëndrojmë bashkë, asnjë nuk do të iki vetëm.
- Dhe askush nuk do të largohet nga rruga.
- Është e rrezikshme këtu në pyll.
- Nuk dua të humbas asnjë nga ju.
- E kuptuat?



Pasi kishin ecur pak, mbërritën në një vend, ku kishte shumë shkurre.

Bastiani i zbulon ato i pari:

- Mjedra, - thërret ai.

Të tjerët ishin te shkurret dhe po e mbushnin gojën plot me mjedra.

- Keni pesë minuta kohë, - thotë zonja Bode.

Pas njëfarë kohe ajo thërret:

- E pra, mjaft tani. Duhet të vazhdojmë.



Kur ishin rrugës, Tina i thotë Timit:

- Sa keq, që duhet të nisemi. Mjedrat ishin aq të shijshme.



Pas dhjetë minutash mbërrijnë te rrënoja.

Fillimisht u ngjitën të gjithë në kullë.

Tina dhe Timi provojnë, sa kohë i duhet pështymës së tyre nga kulla deri në tokë.

Zonja Bode i thotë, kur ishin përsëri të gjithë poshtë:

- Këtu do të bëjmë vetëm gjysëm ore pushim.
- Tani mund të nxirrni bukat tuaja.
- Por, ju lutem qëndroni këtu. Se mos më largohet njeri.

Tina kontrollon, çfarë i ka dhënë mami me vete.

- Oh, jo, - psherëtin ajo, - bukë me djathë!
- Të pëlqen djathi, - e pyet ajo Timin.
- Po, shumë, - përgjigjet Timi dhe qesh.

Tina e pyet Timin:

- E ndërrojmë?
- Me gjithë qejf, - thotë Timi dhe qesh akoma më shumë.

Pastaj i tregon Tinës bukën e tij:

- Edhe kjo me djathë.
- Unë po marr thjesht disa mjedra, - thotë Tina.
- Kjo nuk është e mundur, - pëshpërit Timi.
- Ti e dëgjove, çfarë tha zonja Bode.
- Ajo as do ta vë re këtë gjë, - pëshpërit Tina.
- Deri sa të mbarojë pushimi, jam kthyer me kohë.

Ajo ikën fshehurazi.



Timi pret.

Pas njëfarë kohe zonja Bode pyet:

- A janë vallë të gjithë këtu?
- Po, - thërret Timi shumë shpejt dhe shumë fort.
- Më mirë të numërojmë dhe të shohim nëse të gjithë 29 fëmijët janë këtu, - thotë zonja Bode.

Kush do të fillojë?

- Unë, thotë Elvira dhe thërret fort: Një!
- Dy, - thërret Bastian.
- Tre! - Ky ishte Ahimi.
- Katër, - thotë Timi.

Kështu vazhdon më tej.

- Shpresoj, që Tina të vijë së shpejti, - mendon Timi. Ndryshe, zonja Bode do ta kuptojë, që jemi vetëm 28.
- Njëzet e tetë, - thotë Eva në atë kohë.
- Për një moment është qetësi. Ndërkohë Timi thërret shpejt:
- Njëzet e nëntë.
- Mirë. Atëherë jemi të gjithë, - thotë zonja Bode.
- Askush nuk e vuri re, që Timi numëroi dy herë.



- Do të marrim një rrugë të shkurtër, - thotë zonja Bode dhe marshon vetë përpara.

Timi ecën jashtëzakonisht shumë ngadalë dhe sheh gjithnjë rreth e qark.

-Ku të ketë mbetur vallë Tina?



Tina ndërkohë kishte ngrënë shumë mjedra.

- Tani duhet të kthehem shpejt, - thotë Tina me vete.

Por, kur ajo arrin te rrënoja, kishin ikur të gjithë.

- Çfarë dreq pune!, - bërtet Tina.
- Nga cila rrugë do të jenë kthyer vallë?

Kishte tri rrugë për t'u larguar nga rrënoja.

Tina vendos të marrë atë majtas.

Ajo vrapon aq shpejt, sa mundet. Ku do të jenë tani të tjerët?



Më në fund Timi ndalet. Çfarë të bëjë?

T'i thotë zonjës Bode

, që Tina mungon?

Por, pastaj duhet t'i pohojë zonjës Bode që ka numëruar dy herë.

- Tim, ti po sorollatesh, - i thotë zonja Bode.
- Eja, pra tani.

Timi vazhdon të ecë ngadalë.



Tina vrapon dhe vrapon. Pylli bëhet gjithnjë e më i dendur.

Ajo ndalet dhe sheh përreth.

Diku këputet një degë. Te shkurrja dëgjohej një zhurmë.

Tina mbeti pa frymë nga frika.

Një lepur kërcen nga shkurrja drejt tek ajo.

E lehtësuar kthehet me vrap te rrënoja.

Tani merr prej atje rrugën e mesme. A do të jetë kjo tani e duhura?

	Timi nuk duron dot më? - Zonja Bode. Ndaloni!, - thërret ai. Tina mungon. Dhe ai i tregon, çfarë kishte bërë. Zonja Bode nuk i bërtet fare, ajo shqetësohet jashtëzakonisht shumë. - Kthehuni shpejt! Thërrisni të gjithë emrin e Tinës, - urdhëron ajo. - Duhet të gjejmë Tinën. Të gjithë thërrasin, të gjithë kthehen mbrapsht. Por, Tina nuk është as te rrënoja, as te mjedrat dhe ajo as nuk përgjigjet. - O, zot! Sa e tmerrshme!, - thotë zonja Bode. Është gati të qajë. Duhet të lajmëroj policinë, nuk kam rrugë tjetër.
--	--

	Zonja Bode thërret: - Duhet të shkojmë shpejt te autobuzi. Atje kam celularin tim. Të gjithë fëmijët vrapuan, deri sa mbërritën te autobuzi. Tina ishte ulur aty pranë shoferit. Tina, - ulëret zonja Bode. Tina, nga dole këtu?
	Tina thotë e turpëruar: - Unë humba rrugën. Zonja Bode, më vjen shumë keq. Pata shumë frikë. - Frika ime ishte akoma edhe më e madhe, - thotë zonja Bode. Por, e imja ishte më e madhja, - thotë Timi.
	Fund

